

14.11.2019  
Kancelares  
to kryetar republikës

1885  
14.11.2019



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR  
KORÇE

5036  
18.11.19  
H. Jecani

Korçë, me 07.11.2019

**SHPLLJE VENDIMI**

Ne kendin e afishimit te shpalljes prane Njesise Administrative Libonik, Bashkia Maliq.

Per: Shtetasin **Manolis Kodrasi**  
Me adrese: Fshati Libonik, Njesia Administrative Libonik,  
Bashkia Maliq.

Bashkalidhur po ju dergojme shpalljen për vendimin nr. 1104, dt. 30.09.2019 per t'u afishuar nga ana e juaj njoftimi me shpallje (20 ditore) dhe me pas 5 dite afat ankimi – pasi deftesa e komunikimit eshte kthyer me shenimin se ky shtetas eshte larguar ne Greqi dhe pas afishimit kjo shpallje te na kthehet e konfirmuar me vule e firme, ne gjykate.

KANCELARE  
Lubiana KINOLLI

U afishua sot ne dt \_\_\_\_\_  
Nenpunesi \_\_\_\_\_  
(emer, mbiemer, firme)

Nr. 114 Prot  
07.11.19

- dj. Ad. Libonik  
- Dyt. Inf. Publik ✓  
18.11.2019  
H. Jecani

NR. REGJ.THEM.21001-00806-41-2019 (981)  
DT. REGJ.10.05.2019

NR.VENDIMI 41-2019-3347(1104)  
DT.VENDIMI 30.09.2019

**V E N D I M**  
**“Ne emer te Republikes”**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce e perbere prej:

**Gjyqtare: Eglantina Mikani**

Asistuar nga sekretare gjyqesore Zamira Shkemi, ne Korce, sot ne dt.30.09.2019, ora 09.<sup>31</sup>, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore te zhvilluar me dyer te hapura ceshtjen civile me nr. regj. them. 21001-00806-41-2019 (981), date regj.10.05.2019 qe i perket:

**Paditese : Mirela Curma**, e bija e Vasil dhe Violeta, e dtl.1975, lindur ne Korce dhe banuese ne fshatin Libonik, Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, e martuar me nje femije, perfaqesuar nepermjet procures te posacme me nr.1488 rep. e nr.937 kol. te dt.05.06.2019 nga av.Ledion Spaho.

**I paditur : Manolis Kodrasi**, i biri i Foti dhe Filloreta, i dtl.1976, lindur ne Maliq dhe banues ne fshatin Libonik, Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, i martuar me nje femije, ne mungese.

**Objekti** : Zgjidhje martesore, lenie per rritje dhe edukim te femijes Krisulla Kodrasi e dtl.18.06.2004 paditeses Mirela Curma si dhe rregullimin e pasojave te tjera qe vijne nga zgjidhja e marteses.

**Baza ligjore** : neni 132 e vijues i K.Familjes.

Ne perfundim te hetimit gjyqesor, te zhvilluar ne prani te paditeses dhe te perfaqesuesit te saj me prokure, ne pretendimet perfundimtare u kerkua :

**Perfaqesuesi me prokure i paditeses Mirela Curma av.Ledian Spaho** : pranimin e kerkesepadise sipas objektit te saj;

**I padituri Manolis Kodrasi** : ne mungese;

Gjykata, pasi degjoi shpjegimet e paleve ndergjyqese ne gjykim, shqyrtoi provat shkresore e raportin psikologjik dhe analizoi ne teresi rrethanat e ceshtjes

**V E R E N**

Me kerkesepadi te depozituar ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Korce ne dt.09.05.2019 paditesja Mirela Curma duke thirrur si te paditur bashkeshortin e saj Manolis Kodrasi ka kerkuar “Zgjidhje martesore, lenie per rritje dhe edukim te femijes Krisulla Kodrasi e dtl.18.06.2004 paditeses Mirela Curma si dhe rregullimin e pasojave te tjera qe vijne nga zgjidhja e marteses.” duke i bazuar ato ne nenin 132 e vijues te K.Familjes te titulluar

14.11.2019  
*Sipatja e marteses ligjore me bashkëshortin e saj të paditurit Manolis Kodrasi është e pasojave të rrjedhura prej saj.*

Qe ne fillim te gjykimit nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce u konstatua kryesisht fakti se bazuar ne nenet 36/1 dhe 59/1 te K.Pr.Civile, gjykimi i kesaj ceshtje i perket juridiksionit gjyqesor dhe se kjo Gjykate, ka kompetencen lendore dhe tokesore per shqyrtimin e saj, konform neneve 41 dhe 51 te K.Pr.Civile, si gjykata e vendit ku bashkeshortet kane pasur banimin e tyre te perbashket te fundit ose ne gjykatën e vendit ku ka banimin i padituri qe ne kete rast eshte e njeja gjykate.

Pas kryerjes se veprimeve te pajtimit, te zhvilluara ne seancen e veprimeve pergatitore te dt.05.06.2019, ne prani te te dy paleve ndergjyqese te cilat u paraqiten personalisht, Gjykata arriti ne perfundimin se pajtimi mes bashkeshortëve dhe rikthimi ne nje vazhdimesi normale te martesës i tyre ishte i pamundur. Per kete arsye, Gjykata vendosi kalimin e ceshtjes per shqyrtim ne seance gjyqesore.

Lidhur me themelin e ketij gjykimi, gjate shqyrtimit gjyqesor, nga pohimet e paleve dhe nga provat shkesore rezultoi e provuar si me poshte:

Midis paditeses Mirela Curma dhe te paditurit Manolis Kodrasi eshte lidhur martese ligjore ne dt.18.04.2002 (*provuar me certificate martese leshuar ne dt.08.05.2019 nga Zyra e Gjendjes Civile Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq*) dhe nga martesa iu ka lindur nje femije e quajtur Krisulla Kodrasi e dtl.18.06.2004.

Ka rezultuar e provuar se, palët ndergjyqëse janë lidhur me njëri-tjetrin ne martese me njohje paraprake, njohje kjo e cila ka zgjatur per pak kohe para lidhjes te martesës ligjore. Pas lidhjes te saj palet kane jetuar per disa vite ne familjen prinderore te te paditurit e me pas me lindjen edhe te femijes jane larguar ne emigracion ne shtetin Grek. Pranohet nga te dy palet se fillimisht marredheniet midis tyre kane qene deri diku normale, por me kalimin e kohes marredheniet bashkeshortore kane filluar te tronditen. Mungesa e mirekuptimit, mosperputhja e karaktereve ka pas sjelle qe para 5 vjetesh e konkretisht ne muajin qershor 2014 palet te vecohen perfundimisht nga njeri -tjetri. Paditesja se bashku me vajzen fillimisht eshte larguar ne nje banese tjetër ne te njejtin vend ku jetonin edhe me pare e me pas eshte larguar ne Angli ku edhe eshte me vendqendrim aktualisht. Po keshtu edhe i padituri eshte larguar nga banesa ku jetonte me familjen e tij, por ka vijuar te qendroje ne emigracion ne shtetin Grek. Nga ai moment palet jane vecuar perfundimisht nga njeri-tjetri dhe kane mbajtur kontakte vetem persa i perket te drejtes se prinderimit ndaj vajzes se tyre Krisulla. Ne te tilla rrethana, me pretendimin se, martesa e ka humbur funksionin e saj duke ngelur nje veprim formal paditesja i eshte drejtuar Gjykares te Rrethit Gjyqesor Korce me padine object gjykimi

***Sipas pales paditese, Mirela Curma*** shkak i mosfunksionimit te kesaj marredhenie ka qene sjellja e te paditurit i cili kishte lidhje jashte martesore, kthimi i tij ne oret e vona te nates, mungesa e komunikimit dhe interesimit te tij ndaj familjes dhe ndaj saj ne vecanti, ndjenja e xhelozise etj. rrethana keto te cilat sipas saj cuan edhe ne vecimin fizik mes tyre. Duke vleresuar se per shkak te ketyre rrethana martesa ka humbur kuptimin e saj, duke ngelur vetem nje veprim formal paditesja kerkoj zgjidhjen e martesës ligjore nga e padituri dhe te pasojave te saj.

Ndersa nga ***i padituri Manolis Kodrasi*** i cili eshte paraqitur personalisht ne seance pergatitore, u pretendua nder te tjera se, eshte fakt qe midis tyre ka patur grindje e

mosmarreveshje, por sipas tij kjo vinte per shkak te ndryshimit te sjelljes te vete paditeses e ndikuar nga kushtet ekonomike, te mosperputhjes te karaktereve mes tyre, mungeses se komunikimit mes tyre, nderhyrjes te nenes te paditeses ne marredheniet e tyre bashkeshortore e me pas ftohja emocionale. Ne vleresim te tij, martesja nuk mund te vazhdoje dhe kerkoi zgjidhjen e saj, si dhe ti jepet e drejta e takimit me femijen me te cilen pavaresisht marredhenieve te cilat ka patur me paditesen vazhdon te mbaje kontakte te vazhdueshme dhe perpiqet te perkujdeset per te duke kontribuar ne te holla ne mirerritjen e saj. Lihur me kete te fundit ai u shpreh se cdo muaj vajzes i kalon ne llogari nje shume jo me te vogel se 200 euro si dhe i pergjigjej financiarisht sa here kerkonte qe ajo te kthehej apo te qendronte ne shtetin Grek. Ndersa ne séance gjyqesore i padituri nuk u paraqit ndonese kishte djene rregullisht lidhur me zhvillimin e saj nga séanca e meparshme, duke mos bere me dije ndonje shkak te arsyeshem lidhur me kete mosparaqitje. Ne keto kushte gjykimi u zhvillua ne mungese te tij referuar nenit 179/3 te K.Pr.Civile.

Por pavaresisht sa siper, gjykata nuk e cmoi te nevojshme te hetoje dhe provoje shkakun konkret te kesaj situate konfliktuale, por pasojen qe ajo ka passjell, ne rastin konkret prishjen e harmonise familjare. Per me teper qe gjykates nuk i duhet te shprehet per fajesine sepse asnje prej bashkeshorteve nuk e paraqiti kete kerkim.

Sipas nenit 132 te K.Familjes : *“Secili nga bashkeshortet mund te kerkojne zgjidhjen e martesës kur, per shkak te grindjeve te vazhdueshme, keqtrajtimit...jetesa e perbashket behet e pamundur dhe martesja ka humbur qellimin e saj.”*. Kjo dispozite percakton rastet se kur cdonjerit prej bashkeshorteve, i lind e drejta te kerkoje zgjidhjen e martesës ligjore. Nje nga shkaqet per te cilin secili bashkeshort mund te kerkoje zgjidhjen e martesës jane konfliktet midis tyre, konflikte keto qe per shkak te karakterit te tyre te vazhdueshem e kane bere jetesen e perbashket midis bashkeshorteve te pamundur dhe martesja e ka humbur qellimin e saj ne funksion te mireqenies materiale dhe emocionale te bashkeshorteve.

Nga pohimet e paleve (te pranuar ne gjykim si prove konform nenit 281 te K.Pr.Civile) provohet se konfliktet e vazhdueshme midis paditeses dhe te paditurit kane sjelle si pasoje prishjen e harmonise familjare qe duhet te karakterizoje nje marredhenie martesore normale. Jetesa e perbashket eshte bere e pamundur dhe kjo provohet edhe me faktin se ndarja mes çiftit eshte nje gjendje faktike te pakten prej disa vjetesh. Ne rastin ne gjykim, Gjukata cmon se jemi ne kushtet e ketij neni, konfliktet e vazhdueshme midis paleve per shkak te mungeses te mungeses te respektit reciprok dhe te komunikimit, mosperputhjes te karaktereve etj. i kane cuar ata ne nje gjendje ndarje faktike duke mos i ofruar bashkeshortit tjetër mbeshtetje emocionale (neni 50/2 i K.Familjes), situate qe sipas pohimit te paditeses nuk mund te rikuperohet. Per kete shkak Gjukata cmon se duhet te vendose ***zgjidhjen e martesës ligjore midis paditeses Mirela Curma dhe te paditurit Manolis Kodrasi.***

Ne lidhje me pasojat e zgjidhjes se martesës gjykata ka detyrimin te shprehet per pasojat midis bashkeshorteve dhe per pasojat qe kjo zgjidhje do te sjelle per femijen e mitur Krisulla Kodrasi e dtl.18.06.2004 te lindur nga martesja.

Ne lidhje me te mituren Krisulla Kodrasi, rezulton se, pas vecimit faktik te paleve, ajo ka vijuar te jetoje me nenen e vet, paditesen Mirela, ne Angli ku edhe eshte duke vijuar shkollimin e saj referuar kjo vertetimit te leshuar ne dt.12.06.2019 nga Akademia Bexleyheath. Paditesja rezulton te jete perkujdesur per te gjate gjithë kohes duke ushtruar gjate kesaj kohe edhe pergjegjesine prinderore te drejteperdrejte mbi femijen. Paditesja deklaroi se eshte e punesuar ne shtetin Anglez, me kohe te plote ne nje guzhine restoranti ku

edhe realizon te ardhura te mjaftueshme per te perballuar shpenzimet e saj dhe te vajzes, te ardhura te cilat arrijne deri ne 16.663.35 pound ne vit. Lidhur me keto rrethane prej saj u paraqit edhe nje vertetim te ardhurash nga punedhenesi i saj i dt.15.06.2019, i cili permbante edhe legalizimin perkates referuar nenit 266 te K.Pr.Civile. Ne vijim prej saj eshte deklaruar se perpiqet te punoje gjate kohes kur vajza eshte ne shkolle me qellim per te perballuar shpenzimet ne familje, ndersa kohen tjeter per tju perkushtuar me pas mirerritjes dhe kujdesit ndaj femijes. Me zgjidhjen e martesës ligjore prej saj u kerkua qe femija Krisulla ti lihet asaj per rritje edukim, te caktohet nje pension ushqimor per femijen ne masen qe do te vleresohet e arsyeshme nga gjykata, ndersa per menyren e takimit te te paditurit me femijet te lejohet sipas percaktimit te dhene nga psikologia.

Ndersa per palen e paditur rezultoi se pas vecimit nga paditesja ka vijuar te jetoje ne shtetin Grek, eshte i punesuar ne profesionin si shites ne nje market, rrethane kjo e pohuar edhe nga vete i padituri duke siguruar te ardhura te konsiderueshme deri ne 10.000 euro ne vit. Mban kontakte te rregullta me te dy femijen duke shprehur interesim edhe per mirerritjen e saj.

Referuar nenit 6 dhe 155 te K.Familjes ne séance gjyqesore gjykata ka marre edhe pelqimin e te mitures Krisulla Kodrasi lidhur me faktin se kujt nga prinderit duhej ti besohej ushtrimi i drejteperdrejte i pergjegjesise prinderore pas zgjidhjes te martesës ligjore midis tyre. E mitura ne prani te psikologes, te paditeses dhe te perfaqesuesit te kesaj te fundit ka deklaruar se kerkon te qendroje me nene e saj, paditesen Mirela Curma.

Per te vendosur mbi **menyren e ushtrimit te pergjegjesise prinderore** ne aplikim te nenit 157 te Kodit te Familjes, Gjykata mban parasysh:

-a) qendrimin e vete paleve ndergjyqese : ku paditesja por edhe i padituri jane shprehur se jane dakort qe femija ti lihet paditeses per rritje dhe edukim;

-b) mendimin e psikologes te thirrur nga gjykata ne permbushje te detyrimit ligjor qe buron nga neni 155 i Kodit te Familjes. Ne akt vleresimin psikologjik ajo shprehet per : *".....Lënie e fëmijës të mitur Krisulla Kodrasi për rritje dhe edukim nënës Mirela Curma. Ky rekomandim vjen duke marre parasysh deshiren e femijes per te jetuar me nenen. Femija ndodhet ne stadin e adoleshences eshte ne nje faze qe mund te beje diferencen e aneve pozitive dhe negative te sejcilit prind. Dëshira e fëmijës për të jetuar me nënën është reale dhe e pandikuar. Sipas fëmijes ka raporte dhe komunikim te mire me te dy prinderit por ndihet me e lidhur emocionalisht me nenen. Te dy prinderit jane te angazhuar maksimalisht per plotesimin e nevojave materiale te femijes vecanerisht nena ploteson cdo nevojë materiale dhe shpirtore te femijes.*

*Duke vlerësuar gjithë dinamikën familjare, stilin e prindërimit, marrëdhënien qe ka femija me secilin prind, mendimin e paleve si dhe largesine e babait me femijen :*

*Mendoj se është në interesin më të lartë të fëmijës të jetojë me nënën, për shkak se ndihet me e qete dhe me e sigurte nga jetesa me nenen ....";*

-c) stadin e zhvillimit ne te cilin ndodhet femija, nevojen e saj per mbeshtetjen e nenes, por dhe nevoja per te patur kontakte me atin e saj ;

d) pelqimin e femijes dhene gjate intervistimit te kryer nga psikologia per tju besuar nenes te saj ushtrimi i pergjegjesise prinderore;

Per sa me lart, gjykata konkludon se, ne funksion te kushteve sociale dhe ekonomike ne te cilen ndodhen te dy prinderit, vullnetin e vet paleve, kujdesin e treguar dhe marrëdhënien e vendosur nga secili prej tyre ndaj fëmijës, perceptimin prindëror të sejcilit prej tyre për fëmijën, moshen e femijes (rreth 15 vjec), stilin actual të jetesës që fëmija ka krijuar deri ne keto moment duke jetuar me nenen e saj, lidhjen e fortë qe ajo paraqet me te paditesen pra

nenen e saj duke e perceptuar ate si mbeshtetjen kryesore, por edhe rrethanat e tjera te cilat lidhen me pershtatshmerine e saj, e se fundi kjo edhe ne funksion te interesit me te larte te femijes, e mitura Krisulla Kodrasi duhet t'i lihet per rritje dhe edukim nenes te saj Mirela Curmai. Ndersa ati i saj, i padituri Manolis Kodrasi te kete te drejten te mbikqyre mbajtjen dhe edukimin e femijes si dhe te informohet dhe te konsultohet per zgjidhjet e rendesishme qe lidhen me jeten e saj.

Gjykata cmon gjithashtu se, ***per te ruajtur lidhjen afektive me atin, pra te paditurin pasi figura e te dy prinderve eshte mjaft e domosdoshme per mirerritjen e femijeve, ai ka te drejten e takimit me te.*** Ne lidhje me oraret e takimeve psikologia rekomandoi si te drejte takimi te femijes me atin e saj gjate pushimeve verore 15 diteshin e pare te muajit gusht si dhe takimet gjate pushimeve dimerore nga data 1 janar -5 janar duke patur parasysh komunikimin e mire mes tyre por edhe largesine e te paditurit, rrethane kjo e cila pengon qe takimet te jene me frekvente. Edhe per gjykatën nisur nga rrethanat e rezultuara gjate gjykimit, interesimi qe paraqesin te dy palet por dhe lidhjen qe sejcili prej tyre ka mbajtur me femijen dhe anasjelltas, moshen e femijes dhe reagimin e saj ndaj te dy paleve (prinderve), faktin qe e mitura eshte duke vijuar arsimin e saj ne Angli ku edhe jeton se bashku me nenen e saj, ndersa i padituri jeton e punon ne shtetin Grek e ne pamundeit per ta takuar femijen ne Angli per shkak te mungeses te dokumentacionit, cmohet qe e drejta e takimit dhe e marrjes se femijes prej te paditurit te caktohet sipas rekomandimit te dhene nga psikologia. Ne keto kushte, Gjykata disponon per lenien e femijes te mitur Krisulla Kodrasi e dtl.18.06.2004 per rritje dhe edukim nenes te saj Mirela Curma duke i njohur atit te saj Manolis Kodrasi te drejten per ta takuar ate ne pushimet verore 15 ditet e para te muajit gusht ndersa ne pushimet dimerore javen e pare te cdo viti (nga data 01 janar -07 janar).

Se fundi, ne caktimin e kesaj te drejte takimi gjykata mban parasysh rrethanat konkrete ne te cilat ndodhet aktualisht kjo lloj mardhenie ne momentin e shqyrtimit te padise dhe se ajo eshte e ndryshueshme ne vijim mbi kerkesen e sejciles pale duke u kushtezuar kjo nga ndryshimi i rrethanave apo mardhenies te vendosur midis te paditurit dhe femijes.

Si pasoje e zgjidhjes se martesës, ***Gjykata ka detyrimin te caktojë edhe kontributin per detyrim ushqimor*** qe i padituri duhet te jape ne favor te femijes se tij te mitur, pasi rregullimi i pasojave qe vijne per shkak te zgjidhjes se martesës eshte detyrim qe gjykata duhet ta permbushë edhe kryesisht pavaresisht nga kerkimet e paleve ndergjyqese. Gjykata duke patur parasysh rrethanat e sipercituara lidhur me gjendjen e punesimit te sejciles pale, moshen ne femijes e nevojat e saj per rritje, deklarimet e dhena ne séance nga palet ndergjyqese lidhur me masen e kontributit ushqimor cmon se i padituri duhet te kontribuojë ne procesin e rritjes se femijes dhe plotesimin e nevojave jetesore te saj me nje pension ushqimor ne masen prej 25.000 (njetzet e pese mije) leke cdo muaj, detyrim i cili fillon nga dita e paraqitjes te padise dt.09.05.2019.

Kjo shume vendoset me qellim ruajtjen dhe sigurimin e interesave materiale te femijes por dhe duke mbajtur parasysh nevojat e atij qe e kerkon dhe gjendjen ekonomike te atij qe detyrohet, si dhe faktin qe shpenzimet e tij variojne ne raport me moshen e femijes.

Sipas nenit 146 te K.Familjes :

*“Bashkeshorti qe me lidhjen e martesës ka ndryshuar mbiemrin e tij, pas zgjidhjes se martesës merr mbiemrin qe ka pasur perpara lidhjes se martesës.*

*Gjykata, me kerkesen e njerit bashkeshort dhe kur eshte ne interes te tij ose te femijeve, mund te lejojë qe ai te mbaje mbiemrin qe ka marre me lidhjen e martesës”.*

Ne kushtet kur rezultoi se paditesja Mirela Curma me lidhjen e martesës ligjore nuk ka ndryshuar mbiemrin, por ka zgjedhur të mbaje atë para martesës gjykata e cmon se nuk ndodhet para rregullimit të pasojës të rrjedhur me zgjidhjen e martesës ligjore përse i përket mbiemrit të saj.

Ne aplikim të nenit 143 të Kodit të Familjes dhe të nenit 31 të ligjit nr.10129 dt.11.05.2009 "Për Gjendjen Civile", i ndryshuar Gjykata ka detyrimin që brenda 15 ditëve nga dita që vendimi merr formë të prerë të dergojë për regjistrim një kopje të tij në Zyren e Gjendjes Civile përkatëse, në rastin në gjykim në Zyren e Gjendjes Civile Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq, si zyra ku janë të regjistruar palet.

Përse i përket shpenzimeve gjyqësore ato rezultuan në total në masën 33.260 leke dhe përbehen nga tarifa mbi aktet në masën 3.000 leke, për njoftimin e paleve në masën prej 260 leke dhe për shpërblimin e psikologes në masën prej 30.000 leke, të gjitha të parapaguara nga pala paditëse. Pavarësisht se gjykata në themel u shpreh për pranimin e padisë, nisur nga objekti i gjykimit në bazë të se ciles sejcila pale realizon të drejta personale, kur gjykata në rastin konkret nuk kishte për objekt dhe nuk u shpreh për fajesinë pasi një rrethane e tillë nuk u kerkua edhe nga vete palet, nga gjykata cmohet që këto shpenzime të lihen në ngarkim të pales paditëse sikurse edhe janë kryer.

Referuar përmbajtjes të nenit 511 të K.Pr.Civile të ndryshuar me ligjin nr.38/2017, në të cilin parashikohet shprehimisht se : "*Titulli ekzekutiv vihet në ekzekutim nepermjet leshimit të urdherit të ekzekutimit i cili : a) për rastet e parashikuara nga shkronja "a" dhe "b" të nenit 510 të këtij Kodi leshohet nga gjykata që ka dhënë vendimin në dispozitivin e vendimit*", por dhe ndodhur në kushtet kur ky vendim civil përmban detyrime midis paleve, gjykata është e detyruar të leshojë urdherin e ekzekutimit në dispozitiv të vendimit, i cili behet i ekzekutueshem nga Zyra Përmbartimore me marrjen e tij formë të prerë.

#### **PER KETO ARSYE**

Gjykata bazuar në nenin 132 të K.Familjes dhe nenin 126 dhe 306-310 të K.Pr.Civile

#### **V E N D O S I**

Pranimin e kërkesepadise.

Zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur midis bashkeshortëve Mirela Curma dhe Manolis Kodrasi në dt.18.04.2002.

Lenien e femijes të mitur Krisulla Kodrasi e dtl.18.06.2004 për rritje dhe edukim nënës të saj Mirela Curma duke i njohur atit të saj Manolis Kodrasi të drejtën për ta takuar atë në pushimet verore 15 ditë e para të muajit gusht ndërsa në pushimet dimërore javën e parë të çdo viti (nga data 01 janar -07 janar).

Detyrimin e të paditurit Manolis Kodrasi të paguajë në favor të femijes Krisulla Kodrasi e dtl.18.06.2004 si detyrim për ushqim, shumën prej 25.000 (nëzet e pesë mijë) leke çdo muaj, detyrim i cili fillon nga dita e paraqitjes të padisë dt.09.05.2019.

Urdhërohet kryesekretaria që brenda 15 ditëve nga dita që ky vendim merr formë të prerë të dergojë një kopje të tij në Zyren e Gjendjes Civile Njesia Administrative Libonik, Bashkia Maliq për regjistrim.

Shpenzimet gjyqesore prej 33.260 (tridhjetë tremijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lëke të parapaguara nga pala paditese lihen në ngarkim të saj sikurse janë kryer.

Leshimin e urdherit të ekzekutimit të këtij vendimi me marrjen e tij formë të prere, referuar nën 511 të K.Pr.Civile të ndryshuar.

Kunder këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Korçe brenda 15 ditëve nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar të tij.

U shpall në Korçe, sot në dt.30.09.2019 ora 09.<sup>51'</sup>.

**SEKRETARE**  
**Zamira SHKEMBI**

**GJYQTARE**  
**Eglantina MIKANI**